



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i biznesit: Ndërmarrja Turistike Shërbyese “Eurokoha-Reisen”

Numri i Regjistrimit: 810449836

Drejtor: Nerimane Ejupi

OSHMA: Radio Prishtina

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, pn Emshir



VENDIM

për ripërtëritjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audio – Radio Prishtina, me seli në Prishtinë

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Radio Prishtina është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim regional, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetim tokësor analog të programeve të radios, me seli në Prishtinë. KPM, me vendimin e datës 06 qershor 2016, lëshimin e licencës së Radio Prishtina për një afat prej shtatë (7) vitesh, ndërsa më datën 06 qershor 2023, skadon afati i licencës së Radio Prishtina
- 3.
4. Me datën 18 prill 2023, KPM përmes e-mail ju ka dërguar shkresë të gjitha radiove të cilave afti i licencës ju skadon licenca në vitin 2023, në mesin e tyre edhe Radio Prishtina përmes së cilës shkresë i ka njoftuar lidhur me skadimin e afatit të licencës dhe mundësin e ripërtëritjes së saj në pajtim me Nenin 25 të Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur të Mediave.
5. Më datën 11 maj 2023, Radio Prishtina ka dorëzuar një kërkesë me shkrim në Zyrën Ekzekutive të KPM-së, përmes së cilës ka kërkuar ripërtëritjen e licencës

Arsyetim

6. Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur të Mediave, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.


7. Neni 25 i Ligjit të KPM-së përcakton: *Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audiovizuel privat për sa u përket kushteve dhe kritereve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Komisioni brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.*
8. Me anë të shkresës së datës 18 prill 2023, lidhur me njoftimin për skadimin e afatit të licencës, KPM gjithashtu, ka njoftuar Radio Prishtina lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për ripërtëritjen e licencës.
9. Komisioni konstaton se, Radio Prishtina përmes kërkesës me shkrim ka shprehur interesim për vazhdimin e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve mediale audio (radio) në lokacionin për të cilin është licencuar.
10. Komisioni konsideron se nuk janë evidentuar shkelja të tilla të dispozitave materiale të Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, nga ana e ofruesit të shërbimit medial, Radio Prishtina të cilat shkelje do të pamundësonin ripërtëritje e licencës.
11. Komisioni konstaton se Radio Prishtina ka shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj KPM - së, përfshirë këtu edhe pagesën e tarifës administrative për ripërtëritje të licencës, e paraparë me Rregulloren KPM-2017/06.
12. Komisioni konstaton se kërkesa për ripërtëritjen e licencës së Radio Prishtina është dorëzuar në pajtim me dispozitat ligjore të parapara me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
13. Duke marr parasysh faktin që Radio Prishtina ka dorëzuar kërkesë me shkrim, përmes së cilës ka shprehur interesim për ripërtëritjen e licencës për të vazhduar veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve mediale audio, nuk janë evidentuar shkelje serioze të dispozitave materiale si dhe se ka shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj KPM-së, Komisioni vlerëson se kërkesa për ripërtëritjen e licencës së Radio Prishtina i plotëson kushtet për miratim dhe njëherit ripërtëritja e licencës së kësaj radioje është në interesin e publikut, në zonën në të cilën operon Radio Prishtina.

Vendim

14. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 23 qershor 2023, merr vendim për miratimin e kërkesës për ripërtëritjen e licencës të Radio Prishtina, në mënyrë që të vazhdoj me veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve mediale audio, e cila veprimtari është në interes të publikut në lokacionin për të cilin është licencuar dhe në të cilin është duke transmetuar program Radio Prishtina.
15. Licenca e Radio Prishtina do të jetë e vlefshme për një afat prej shtatë (7) vitesh, ashtu siç është përcaktuar me Nenin 21, paragrafin 2, të Ligjit për KPM-në, ndërsa vlefshmëria e afatit të licencës do të llogaritet nga data 6 qershor 2023.

16. Të gjitha parametrat e licencës së Radio Prishtina, siç janë: kategoria e të licencuarit, skema programore, parametrat teknike dhe harta e zonës së mbulimit do të mbesin të pandryshuar nga licenca paraprake.

17. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



23.06.2023

datë